



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveri-Vlada-Government

RREGULLORE (QRK) NR.16/2023
PËR FUNKSIONIMIN DHE PUNËN NË QENDRËN PËR STREHIMIN, MBROJTJEN
DHE REHABILITIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE,
NË NIVEL TË MESËM DHE TË LARTË TË RREZIKSHMËRISË¹

¹ Rregullore (QRK) Nr.16/2023 për Funkcionimin dhe Punën në Qendrën për Strehimin, Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore, në Nivel të Mesëm dhe të Lartë të Rrezikshmërisë është miratuar me Vendimin Nr. 08/174 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 22.11.2023

Qeveria e Republikës së Kosovës,

Në përputhje me nenin 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 23 (4), nenin 48, (4) të Ligjit Nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, nenit 8, nenin 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenit 38, paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011,

Nxjerr:

RREGULLORE (QRK) NR. 16/2023 PËR FUNKSIONIMIN DHE PUNËN NË QENDRËN PËR STREHIMIN, MBROJTJEN DHE REHABILITIMIN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT ME QENIE NJERËZORE, NË NIVEL TË MESËM DHE TË LARTË TË RREZIKSHMËRISË

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Kjo Rregullore përcakton funksionimin dhe punën në Qendrën për Strehimin, Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore, në Nivel të Mesëm dhe të Lartë të Rrezikshmërisë, menaxhimin e Qendrës përfshirë procedurën e pranimit, regjistrimit, akomodimit, lëvizjen e viktimave të trafikuar dhe atyre të supozuara brenda Qendrës si dhe largimin vullnetar nga Qendra.

2. Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet sanitare, higjienike, ushqimi, ndihma mjekësore, juridike, psikologjike, edukuese, rendi shtëpiak, si dhe çështje tjera të rëndësishme lidhur me punën e Qendrës.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e Rregullores zbatohen nga të gjithë të punësuarit në Qendër, Policinë e Kosovës, vizitorët, punëtorët e kontraktuesve të MPB-së, ofruesit e tjerë të shërbimeve me rastin e qasjes – hyrjes dhe daljes gjatë qëndrimit të tyre në objektet e Qendrës, dhe ndaj të gjithë viktimave të trafikuar dhe atyre të supozuara të vendosura në Qendër.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Shprehjet dhe shkurtesat e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:

1.1. **Trafikimi me njerëz** - ka kuptimin si në vijim: rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose pranimi i personave, përfshirë shkëmbimin ose transferimin e kontrollit mbi këta persona, me anë të kanosjes ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, lajthitjes, keqpërdorimit të pushtetit apo të keqpërdorimit të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies ose marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, me qëllim të shfrytëzimit;

1.2. **Fëmijë** - personi i cili nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet;

1.3. **Viktimë e trafikimit** - çdo person që ka qenë subjekt i një veprimi apo praktike, siç përcaktohet në paragrafin 1, nënparagrafin 1. të këtij neni;

1.4. **Viktimë e ndjeshme** - është viktima e veprës penale e cila është fëmijë, person me aftësi të kufizuara fizike apo mendore, person me aftësi të zvogëluar, grua shtatzënë, i/e moshuar ose person, marrëdhënia apo varësia e të cilit ndaj kryesit e bën atë veçanërisht të ndjeshëm ndaj viktimizimit të përsëritur, frikësimit të përsëritur apo hakmarrjes së përsëritur.

1.5. **Viktimë e supozuar** - person që supozohet të jetë viktimë e trafikimit me njerëz, por që nuk është identifikuar formalisht nga autoritetet relevante, ose që ka refuzuar të identifikohet formalisht si e tillë. Një person i supozuar si i trafikuar gëzon të njëjtat të drejta dhe trajtim, si edhe viktimat e identifikuara që nga fillimi i procesit identifikues;

1.6. **I akomoduar** - personat të cilët janë të strehuar në Qendër (viktimë e trafikimit, viktimë e supozuar, dëshmitar i mbrojtur);

1.7. **Person i mbrojtur** - personi, ndaj të cilit zbatohen masat e mbrojtjes, i cili në cilësinë e dëshmitarit ose të personit të dëmtuar, bën njoftime ose dëshmon për fakte e rrethana, që përbëjnë objekt prove relevante në një procedurë penale;

1.8. **Shfrytëzim i viktimit** - përfshin, por nuk kufizohet në shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve, pornografisë ose formave tjera të shfrytëzimit seksual, lëmshës, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve apo qelizave;

1.9. **Ruajtja e informacionit** - nënkupton gjithë dokumentacionin e ruajtur në dosjen e viktimit në qendër, si dhe bartjen e informacioneve nga qendra për ofruesit tjerë të shërbimeve dhe anasjelltas. Të gjitha të dhënat e viktimit apo të atyre të supozuara, duhet të trajtohen bazuar në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe legjislacionit në fuqi;

1.10. **Periudha e reflektimit** - periudhë që iu vihet në dispozicion viktimit apo dëshmitarëve të trafikimit për tu rimëkëmbur nga përvoja e përjetuar dhe për të marrë vendim nëse do të bashkëpunojnë apo jo me autoritetet kompetente;

1.11. **Mekanizmi kombëtar i referimit** - strukturë bashkëpunuese nëpërmjet së cilës institucionet shtetërore i përmbushin obligimet për t'i mbrojtur dhe promovuar të drejtat e viktimës së trafikimit me njerëz dhe koordinojnë përpjekjet e tyre në një partneritet strategjik me shoqërinë civile;

1.12. **Grupi i ndihmës i drejtpërdrejtë-GND** - ofruesit e shërbimeve të cilët koordinojnë veprimet dhe gjetjen e formave më adekuate për ndihmë dhe zgjidhje të rastit (Policia e Kosovës/Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Njerëz, Qendra për Punë Sociale, mbrojtësi i viktimave dhe menaxheri i rastit në Qendër);

1.13. **Menaxheri i rastit në Qendër** - profesionisti i licencuar i Qendrës që këshillon dhe asiston personin e akomoduar;

1.14. **Menaxheri i rastit** - Ai/ajo është zyrtar/e i/e shërbimeve sociale i/e caktuar nga Qendra për Punë Sociale në rastin e një fëmije të trafikuar, dhe si mbrojtës i viktimës që është emëruar nga Zyra për Mbrojtje të Viktimës në rast të një personi të rritur të trafikuar;

1.15. **Arsimi joformal** - arsimi *joformal* i referohet të nxënit tjetër, jashtë atij që ofrohet nëpërmjet programeve të përshkruara në përkufizimin “arsimi formal”;

1.16. **Mbështetja psiko-sociale** - tërësia e veprimeve që adresojnë dhe trajtojnë si nevojat psikologjike, ashtu edhe ato sociale të viktimave të trafikuar;

1.17. **Qendra** - nënkupton Qendrën për Strehimin, Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore, në Nivel të Mesëm dhe të Lartë të Rrezikshmerisë. (në tekstin e mëtejshëm: Qendra);

1.18. **Operator ekonomik** - term i përgjithshëm që përfshinë furnizuesin, ofruesin e shërbimeve dhe/ose kontraktuesin e punëve;

1.19. **MPB** - Ministria e Punëve të Brendshme;

1.20. **DRPRIH** - Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve;

1.21. **KKKT**- Koordinatori Kombëtar Kundër Trafikimit;

1.22. **ZKK** - Zyra e Koordinatorit Kombëtar;

1.23. **AKKTNJ** - Autoriteti Kombëtar Kundër Trafikimit me Njerëz;

1.24. **SMESN** - Sekretariati për Monitorim dhe Evoluim të Strategjive;

1.25. **MFPT** - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;

1.26. **MD** - Ministria e Drejtësisë;

- 1.27. **MASHTI**- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- 1.28. **MSH** - Ministria e Shëndetësisë;
- 1.29. **QPS** - Qendra për Punë Sociale;
- 1.30. **PSH**- Prokuroria e Shtetit;
- 1.31. **KGJK** - Këshilli Gjyqësor i Kosovës;
- 1.32. **ZMNV**- Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave;
- 1.33. **PK**- Policia e Kosovës;
- 1.34. **DHTNJ** - Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me Njerëz;
- 1.35. **PSV**- Procedurat Standarde për Veprim.
- 1.36. **IAP**-Institucioni i Avokatit të Popullit.

Neni 4 Funksionimi i Qendrës

1. Qendra funksionon në kuadër të DRPRIH /MPB.
2. Qendra administrohet nga Udhëheqësi/ja i/e Qendrës.
3. Qendra ofron strehim, siguri, mbrojtje, dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit dhe viktimave të supozuara.

Neni 5 Parimet bazë

1. Qendra vendos të drejtat e viktimave të trafikimit dhe viktimave të supozuara në fokus të çdo aktiviteti dhe shërbimi.
2. Viktimat e identifikuara si të trafikuar apo të supozuara si të trafikuar, do trajtohen në mënyrë të barabartë, pa diskriminim në baza të identitetit gjinor, moshës, racës, nacionalitetit, etnisë, gjuhës, fesë, orientimit seksual dhe pikëpamjeve politike gjatë tërë qëndrimit në Qendër.
3. Qendra do t'iu jap prioritet fëmijëve që dyshohet se kanë qenë të trafikuar. Një vlerësim i shpejtë dhe i tërësishëm i interesit më të mirë të tyre, duhet të bëhet në pajtim të plotë me legjislacionin në fuqi.

4. Qendra, inkurajon dhe mbështet viktimat e trafikimit dhe ato të supozuara, që të jenë pjesëmarrëse në proceset e vendimmarrjes që ndërlidhen me interesin më të mirë të tyre.
5. Qendra, vlerëson, informon dhe ofron shërbimet e nevojshme dhe të pakushtëzuara për viktimat e trafikimit, viktimat e supozuara të trafikimit dhe dëshmitarët e mbrojtur.
6. Ruajtja e konfidencialitetit dhe integritetit personal të viktimave të trafikimit, viktimave të supozuara dhe dëshmitarit të mbrojtur, është obligim i të punësuarve në Qendër dhe ofruesve tjerë të shërbimeve të përfshirë në raste.

Neni 6

Mandati, roli dhe përgjegjësitë e Qendrës

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Qendrës janë:

- 1.1. ofron siguri, mbrojtje, strehim për viktimat e trafikimit, bazuar në trajtimin e barabartë dhe mos-diskriminim;
 - 1.2. Ofron mbështetje për kthimin e asistuar vullnetar për viktimat e huaja sipas legjislacionit në fuqi;
 - 1.3. Ofron shërbime psiko-sociale, të ushqimit, veshmbathjes, higjienës, produkte farmaceutike, edukim për viktimat e strehuara;
 - 1.4. Mbron dhe ruan të dhënat e viktimave të strehuara në kuadër të strehimores;
 - 1.5. Informon dhe ofron këshilla për viktimat mbi të drejtat e tyre, sipas legjislacionit në fuqi;
 - 1.6. Bashkëpunon dhe komunikon me të gjitha institucionet relevante, të cilat janë të angazhuara me qëllim të trajtimit sa më të mirë të viktimave të strehuara;
 - 1.7. Strehon dëshmitarët e mbrojtur për rastet e trafikimit para dhe gjatë procedurës.
2. Udhëheqësi i Qendrës i raporton drejtorit të Departamentit për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve.
 3. Udhëheqësi i Qendrës raporton te Koordinatori Kombëtar kundër Trafikimit me Njerëz në bazë të Strategjisë, Planit të Veprimit Kundër Trafikimit me Njerëz.
 4. Struktura Organizative e Qendrës është e përcaktuar sipas Rregullores për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Neni 7

Kapaciteti i Qendrës

Qendra ka kapacitet të strehojë dyzet (40), viktimë të trafikimit apo viktimë të supozuara, dëshmitarë të mbrojtur vendorë dhe ndërkombëtarë, femra, meshkuj, të rritur, fëmijë, si dhe prindër të shoqëruar me fëmijë.

KAPITULLI II

PRANIMI I VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

Neni 8

Procedura e pranimit të viktimave të trafikimit në Qendër

1. Me rastin e referimit të rastit të ri në Qendër, Policia e Kosovës/DHTNJ është e obliguar të lajmëroj sa më parë Udhëheqësin /en e Qendrës, me qëllim të përgatitjes për pranimin e rastit për strehim.
2. Me pranimin e viktimës në Qendër, Policia e Kosovës/DHTNJ dorëzon formën bazike të të dhënave për rastet.
3. Forma bazike e të dhënave duhet të jetë e nënshkruar nga Mbrojtësi i Viktimës, Policia e Kosovës dhe në rastin kur viktimë është nën moshën 18 vjeçare edhe nga Qendra për Punë Sociale.
4. Stafi i Qendrës me rastin e pranimit të viktimës, obligohet të kontrollojë dhe evidentojë në praninë e Policisë së Kosovës dhe viktimës, gjësendet që posedon viktimë, gjërat me vlerë, stafi i Qendrës i siguron një vend të caktuar dhe të sigurt, me ç'rast viktimë dhe stafi i Qendrës nënshkruajnë formën e pranim-dorëzimit.
5. Qendra obligohet t'i ruaj gjësendet e secilës viktimë që pas vendimit për largim t'i dorëzohen në gjendjen e njëjtë, siç edhe janë pranuar.
6. Pas strehimit të viktimës ai/ajo duhet të njoftohet me rregullin shtëpiak të Qendrës në gjuhën që e kupton dhe të deklarohet nëse pajtohet me rregullin shtëpiak. Në fund, nënshkruhet një formular nga viktimë dhe stafi i Qendrës.
7. Qendra me të pranuar viktimën e trafikimit dhe viktimën e supozuar, bën vlerësimin individual të nevojave, cakton menaxherin e rastit i cili jo më larg se 72 orë thërret grupin e ndihmës së drejtpërdrejtë dhe harton planin individual brenda Qendrës.
8. Qendra bën pranimin e viktimave të trafikimit dhe atyre të supozuara të referuara nga institucionet kompetente, bazuar në Procedura Standarde të Veprimit për Personat e Trafikuar në Kosovë.
9. Qendra obligohet të sigurojë përkthim të dokumenteve të shkruara dhe përkthim verbal në gjuhën që viktimë e flet dhe e kupton.

Neni 9

Akomodimi

1. Qendra akomodon viktimat e trafikimit me njerëz apo viktimat e supozuara në bazë të nevojave të vlerësuara për një periudhë tridhjetë (30) deri në nëntëdhjetë (90) ditë.
2. Kohëzgjatja e akomodimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni mund të vazhdohet:
 - 2.1. Në bazë të rekomandimit të mjekut gjatë periudhës së trajtimit mjekësor, por jo më gjatë se 6 muaj;
 - 2.2. Në bazë të kërkesës së organeve të ndjekjes penale apo të gjykatës gjatë periudhës së procedurës penale, dhe kur jeta apo shëndeti i viktimës janë të kanosur nga rreziku real, kohëzgjatja e akomodimit mund të vazhdohet edhe pas përfundimit të procedurës penale për një periudhë e cila konsiderohet e nevojshme për mbrojtjen e viktimës, bazuar në kërkesën e Prokurorit;
 - 2.3. Në bazë të kërkesës së viktimës së trafikimit me njerëz, në të cilën jepet arsyetimi, për një periudhë deri në nëntëdhjetë (90) ditë.
3. Gratë shtatzëna, të cilat janë viktimat e trafikimit me njerëz, kanë të drejtë të akomodimit në Qendër për një periudhë deri në një (1) vit, me mundësi vazhdimi.
4. Viktimat e trafikuar, supozuara akomodohen në dhoma të veçanta individuale.
5. Në rast se viktimat e trafikimit është prind me fëmijë, viktimat mund të strehohen bashkë me fëmijët e vegjël të tyre në Qendër.
6. Secili i strehuar i cili akomodohet në Qendër, do të ketë shtrat të veçantë me një dyshek të mbuluar, një jastëk dhe çarçaf shtrati.
7. Pajisjet të cekura në paragrafin 6 të këtij neni, pastrohen në baza të rregulta dhe ndërrohen sipas nevojës.
8. Viktimat e strehuar nuk mund të ndërrojnë dhomën e gjumit pa pëlqimin paraprak të zyrtarit përgjegjës.
9. Në rast nevojë, personeli i autorizuar mund t'a ndërrojë hapësirën për viktimën brenda Qendrës dhe për këtë njoftohet viktimat.
10. Hapësirat e rezervuara ekskluzivisht për një viktimë, janë rreptësisht të ndaluara për viktimën tjetër.
11. Staf i Qendrës e ka për obligim të mbikëqyr shfrytëzimin e hapësirës së Qendrës nga viktimat.

12. Personeli i autorizuar i Qendrës mund të hyjë në dhomën e viktimës; pa prezencën ose lejen e tij/saj, nëse mendohet se dhoma përdoret në një mënyrë ose për një qëllim tjetër se ç'është planifikuar nga Qendra.

Neni 10 **Shërbimet dhe aktivitetet**

1. Shërbimet e ofruara për viktimën e trafikimit, viktimat e supozuara, dëshmitarin, të strehuarit në Qendër përfshijnë:

1.1. Sigurimin e ushqimit;

1.2. Veshëmbathjen;

1.3. Pakot higjienike dhe materiale;

1.4. Produktet farmaceutike;

1.5. Këshillime psiko-sociale, kujdes shëndetësor gjatë qëndrimit në Qendër;

1.6. Arsim joformal dhe edukim joformal;

1.7. Shërbime përkthimi dhe interpretimi, sipas nevojës në një gjuhë që viktimat mund ta kuptojnë;

1.8. Qendra ofron aktivitete sociale dhe rekreative brenda dhe jashtë në hapësirë të objektit të Qendrës.

1.9. Viktimave të strehuara në Qendër, iu ofrohet edukim joformal për shkathtësitë jetësore. Qëllimi i edukimit joformal është të kontribuojnë për zhvillimin personal, emocional dhe social të viktimave, (kujdesi për veten, motivimi, vetëbesimi, vetëdija për të drejtat dhe përgjegjësitë, shkathtësitë ndërpersonale, shkathtësitë e marrjes së vendimeve, shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve, shkathtësitë e komunikimit).

Neni 11 **Ruajtja dhe ndarja e informacionit**

1. Për të ruajtur privatësinë e viktimave të strehuara, identiteti dhe informacioni mbi rastet, ruhet sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe dispozitave tjera të legjislacionit në fuqi.

2. Mos zbatimi i paragrafit 1 të këtij neni dënohet në bazë të legjislacionit në fuqi.

3. Qendra bën ndarjen e informacionit për viktimën me ZKK/MPB, DHTNJ, QPS, ZMNV.

4. Ndarja e informacionit me institucionet tjera përgjegjëse, bëhet duke e respektuar legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 12 **Qasja në Qendër**

1. Përveç stafit, qasja iu lejohet:

1.1 Prokurorisë së Shtetit;

1.2. Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit me Njerëz - Policia e Kosovës;

1.3. Mbrojtësit të viktimave;

1.4. Punëtorit social nga QPS- menaxheri i rastit dhe kujdestari ligjor nga QPS;

1.5. Zyrtarëve përkatës të DRPRIH, nëse një gjë e tillë kërkohet;

1.6. Zyrtarëve tjerë të autorizuar profesionistë që ofrojnë drejtpërdrejt shërbime për viktimat: psikologu, stafi shëndetësor, pika e kontaktit për rastet transnacionale, mësimdhënësi sipas nevojës;

2. Për kontakt me viktimat e trafikimit sipas nënparagrafit 1.6. të këtij neni, duhet të merret parasysh vullneti i viktimës në pajtueshmëri me Grupin e Ndhmës së Drejtpërdrejtë.

3. Në rast të shprehjes së interesimit për vizitë në Qendër, subjektet e tjera, si: deputetët nga Kuvendi i Kosovës, zyrtarë përkatës nga Qeveria, institucione apo partnerë ndërkombëtar, pjesëtarë të organizatave joqeveritare, janë të obliguar që paraprakisht të marrin leje me shkrim nga MPB-ja.

4. MPB-ja, informon Qendrën për lejen e lëshuar, duke përfshirë të dhënat dhe identitetet e vizitorëve.

5. Për çdo vizitë në Qendër që është marrë leje paraprakisht Udhëheqësi/ja i/e Qendrës duhet të informoj drejtorin/en e DRPRIH.

6. Secili vizitor regjistrohet në regjistrin e vizitorëve, përfshirë emrin dhe mbiemrin, institucionin përkatës (dokumentin e identitetit), datën e vizitës, kohën e hyrjes dhe daljes.

7. Në rastet emergjente të rrezikut të jetës apo shëndetit të personave në Qendër, si dhe rrezikut ndaj pronës, përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, qasje në Qendër iu lejohet edhe personave të autorizuar për raste emergjente.

Neni 13

Bashkëpunimi

Qendra komunikon dhe bashkëpunon me institucionet relevante që janë të angazhuara në luftimin e trafikimit gjithnjë duke u mbështetur dhe respektuar procedurat standarde të veprimit për viktimat e trafikimit dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 14

Dosjet e viktimave dhe ruajtja e tyre

1. Çdo të strehuari/e, në qendër, duhet t'i krijohet dosja personale e cila duhet të kompletohet nga stafi i Qendrës dhe të ruhet në vend të sigurt në kopje fizike dhe elektronike.
2. Dosja personale hapet me rastin e pranimit në Qendër të shfrytëzuesit/es dhe mbyllet me rastin e largimit të strehuarit/es nga Qendra.
3. Dosja e mbyllur kalon në pasiv, ndërsa në rast të përsëritjes së të njëjtit rast, dosja aktivizohet.
4. Ruajtja e të dhënave personale bëhet sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 15

Takimet e viktimave me familjarët dhe korrespondenca

1. Qendra pas aprovimit paraprak nga GND i mundëson viktimave vendore dhe atyre të huaja, kontaktin përmes telefonit me familjarët apo personat e rëndësishëm në jetën e tyre dhe koordinon takimet përmes menaxherit jashtë Qendrës.
2. Çdo takim apo komunikim i viktimës sipas paragrafit 1 të këtij neni, evidentohet në regjistrin e vizitave dhe shënimeve të Qendrës.
3. Pas pranimit të kërkesës nga menaxheri i rastit, Qendra obligohet të përgatis viktimën për kontaktin.
4. Kontakti përmes telefonit të Qendrës, është i lejuar një (1) herë në javë në prezencë të stafit të Qendrës dhe në raste specifike orari mund të ndryshoj.
5. Vendi i takimit duhet të jetë i sigurt dhe i përshtatshëm dhe nuk mund të cënohet siguria, dinjiteti dhe ndjeshmëria e viktimës.
6. Pas kthimit të viktimës në Qendër, menaxheri i rastit obligohet që të kryejë kontrollin rutinë dhe të evidentojë gjendjen e viktimës.

Neni 16

Trajtimi në kujdesin parësor shëndetësor dhe hospitalizimi

1. Pas trajtimit në kujdesin parësor shëndetësor të viktimës, në rast se viktima e strehuar me rekomandimin e specialistit shëndetësor duhet të hospitalizohet, viktima dërgohet në hospitalizim.
2. Staf i Qendrës shoqëron dhe ndihmon viktimën në përcjellje të Policisë së Kosovës, deri në institucionin ku bëhet hospitalizimi.
3. Qendra siguron produkte medicinale në rast se kërkohen dhe kryen vizita të rregullta, derisa viktima është e hospitalizuar në institucion shëndetësor.
4. produktet medicinale iu jepen viktimave sipas rekomandimit të profesionistit shëndetësor.
5. Për vajzat dhe gratë shtatzana, duhet të sigurohet qasje në kujdes shëndetësor para dhe gjatë lindjes, këshillim dhe edukim për shëndetin e nënës dhe fëmijës.
6. Në bazë të vlerësimit të secilit rast, Qendra adreson trajtimin e viktimave të akomoduar të cilat kanë varësi nga substancat narkotike dhe në bazë të rekomandimeve të specialistit mjekësor, viktimave iu rekomandohet trajtimi në institucionin shtetëror apo institucionet e specializuara për trajtim shëndetësor nga varshmëria e substancave narkotike.
7. Staf i Qendrës shoqëron dhe ndihmon viktimën në përcjellje të Policisë së Kosovës deri në institucionin shtetëror apo institucionet e specializuara për trajtim nga varshmëria e substancave narkotike.
8. Qendra obligohet të informoj menaxherin e rastit për veprimat e ndërmarra nga ky nen.

Neni 17

Mbështetja, psiko-sociale

1. Mbështetja psiko-sociale sigurohet për viktimat e trafikimit të cilët vuajnë nga pasojat e përjetimeve traumatike, çrregullimet e shëndetit mendor.
2. Këshillimin dhe ndihmën psikologjike, mbi baza konfidencialiteti dhe me respektim të plotë të privatësisë së personit në fjalë, në një gjuhë që ai ose ajo e kupton.
3. Mbështetja psiko-sociale adreson dhe trajton nevojat psikologjike të viktimave të trafikimit më qëllim që të lehtësojë riaktivizimin, rikuperimin e aftësive dhe tejkalimin e problemeve.
4. Natyra e mbështetjes psiko-sociale përcaktohet nga specialistët përkatës të shëndetit mendor, në bazë të vlerësimit të nevojave individuale të secilit rast.
5. Personat në nevojë për mbështetje psiko -sociale referohen te institucionet përkatëse shëndetësore dhe organizatat e specializuara për mbështetje psiko-sociale.

6.Stafi i Qendrës shoqëron dhe ndihmon viktimën në përcjellje të Policisë së Kosovës, deri në institucionin shtetëror apo institucionet e specializuara për trajtim.

7.Qendra obligohet të informoj menaxherin e rastit për veprimet e ndërmarra nga ky nen.

KAPITULLI III RREGULLAT E KUSHTEVE MATERIALE

Neni 18 Ushqimi

1. Të gjithë të akomoduarve iu sigurohen tri shujta ditore dhe pije freskuese.
2. Ushqimi shërbehet në orët e mëposhtme:
 - 2.1. Mëngjesi, 08:00- 09:00;
 - 2.2. Dreka, 12:00- 13:00;
 - 2.3. Darka, 18:00- 19:00.
3. Ushqimi ruhet në kushte të përshtatshme.
4. Ushqimi duhet t'i ofrohet viktimës duke i respektuar kufizimet shëndetësore, dietike, fetare dhe kulturore.
5. Vajzave dhe grave shtatzëna të cilat kanë nevoja për ushqim të posaçëm, i sigurohet ushqimi sipas rekomandimeve mjekësore.
6. Foshnja u sigurohet ushqim i përshtatshëm.
7. Të drejtën e shfrytëzimit të ushqimit e ka edhe stafi i Qendrës.
8. Stafi i ndërrimit në Qendër bën pranimin e ushqimit.
9. Produktet ushqimore duhet të sigurohen nga furnizuesi sipas kontratës.
10. Personeli i Qendrës në raste specifike mund të ndryshoj orarin e ushqimit për të akomoduarit.
11. Në rast nevoje, Qendra mund të kërkojë sigurimin e artikujve shtesë ushqimorë bazik nga buxheti i DRPRIH, apo organizatat mbështetëse.
12. Viktimave më kërkesa të posaçme shëndetësore, iu sigurohet ushqim i posaçëm sipas rekomandimeve mjekësore.

13. Fëmijët duhet të marrin ushqim të përshtatshëm për zhvillim sipas moshës së tyre.
14. Viktimës i sigurohet në vazhdimësi ujë i pastër dhe i pijshëm.
15. Në rast se, në vazhdimësi refuzohet ushqimi nga ana e të akomoduarit, Qendra njofton GND-në.

Neni 19 Veshmbathjet

1. I akomoduari ka të drejtë të përdorë veshjet e tij/saj, nëse ato janë të përshtatshme.
2. Qendra iu siguron të akomoduarve veshjet e përshtatshme sipas nevojave.

Neni 20 Kushtet higjienike dhe sanitare në Qendër

1. Të akomoduarve iu ofrohen kushte optimale higjienike, mjedis i pastër brenda dhe jashtë objektit, pajisje dhe mjete të nevojshme për higjienën personale.
2. Të akomoduarve iu sigurohen mjete të nevojshme për higjienën personale.
3. Gjatë kohës sa viktima qëndron në Qendër, inkurajohet që të kujdeset për higjienën personale dhe mirëmbajtjen e dhomës ku qëndron vet viktima.
4. Dhoma në të cilën vendoset viktima, duhet të jetë e pastër, e ajrosur rregullisht me ndriçim, si dhe të ketë temperaturë konstante, varësisht prej kushteve klimatike.

KAPITULLI IV TË DREJTAT DHE RREGULLAT

Neni 21 Informimi dhe këshillimi

1. Pas strehimit në Qendër, të akomoduarit informohen dhe këshillohen për të drejtat dhe rregullat gjatë qëndrimit.
2. Qendra është e obliguar të sigurojë informatat në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në gjuhën që e kuptojnë të akomoduarit.
3. DRPRIH/SMESN/AKKTNJ në bashkëpunim me institucionet relevante, përgatit broshurat informative për viktimat.

4. Gjatë qëndrimit në Qendër, të akomoduarit informohen se nuk kanë të drejtë për qasje në internet.
5. Të akomoduarit informohen se mund t'i kryejnë ritet e tyre fetare në Qendër.

Neni 22

Liria e fesë dhe shprehjes

1. Të gjithë personat e akomoduar në Qendër, kanë të drejtë ta praktikojnë lirisht fenë e tyre.
2. Qendra ofron hapësirë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për praktikimin e fesë në mënyrë neutrale dhe jo diskriminuese.

Neni 23

Organizimi i aktiviteteve kulturore, arsimore dhe sportive

1. Qendra brenda ambientit organizon aktivitete kulturore, arsimore dhe sportive me qëllim të rehabilitimit dhe riintegrit të viktimave.
2. Për realizimin e aktiviteteve kulturore, arsimore dhe sportive të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, Qendra siguron hapësira dhe pajisje të nevojshme, si dhe koordinohet me drejtoritë përkatëse sipas specifikave të veçanta, ndërsa për realizimin e procesit mësimor dhe vlerësimin e fëmijës, Qendra koordinohet me Drejtorit Komunale të Arsimit.
3. Pas përfundimit të procesit mësimor që realizohet në Qendër dhe vlerësim nga ana e mësimitdhënësve që i cakton Drejtoria Komunale e Arsimit, është obligim që secila shkollë brenda territorit të Kosovës ta njeh këtë vlerësim dhe ta integrojë atë në proces të rregullt mësimor.
4. Qendra informon fëmijën që në rast të pamundësisë së realizimit të mësimin në Qendër, Drejtoria Komunale e Arsimit dhe shkolla, duhet t'i organizojë mësim plotësues sipas legjislacionit në fuqi.
5. Procesi i edukimit përfshin aktivitete të ndryshme me qëllim të rehabilitimit dhe rekreacionit, duke i përfshirë në grup apo individual personat e akomoduar në Qendër, duke iu dhënë mundësi atyre që të zhvillojnë ndjenjën e përgjegjësisë dhe të vetëbesimit.
6. Qendra ofron kushte për lexim të literaturës, si dhe qasje në kanale të përshtatshme televizive.
7. Qendra posedon bibliotekën e cila është e qasshme për të akomoduarit e strehuar.

Neni 24

Rregullat e përgjithshme në Qendër

1. Rregullat e përgjithshme përfshijnë:
 - 1.1. Qendra duhet të krijojë ambient përkrahës dhe miqësor;

1.2. Stafit dhe personat e autorizuar, duhet të kenë qasje dhe sjellje profesionale në të gjithë hapësirat brenda dhe jashtë objektit;

1.3. Të gjithë personat e autorizuar, përveç stafit të Qendrës dhe DHTNJ /Policisë së Kosovës, duhet të identifikohen dhe të regjistrohen në librin për evidentim të hyrje-daljeve;

1.4. Respektimi i orarit të gjumit;

1.5. Evitimi i zhurmave të panevojshme brenda dhe jashtë objektit;

1.6. Secili duhet të sillet me respekt të ndërsjellë ndaj njëri-tjetrit.

1.7. Pirja e duhanit lejohet vetëm në vende të caktuara.

Neni 25 **Mirëmbajtja e Qendrës**

1. Mirëmbajtja e Qendrës realizohet nga Operatori Ekonomik i kontraktuar në MPB.
2. Si rregull, dezinfektimi, deratizimi dhe dezinspektimi i hapësirave, i pajisjeve dhe instalimeve të Qendrës, bëhet në baza të rregullta, parimisht çdo tre muaj.

Neni 26 **Organizimi dhe orari i punës së personelit**

1. Gjatë orarit të punës personeli angazhohet në zbatimin e planit individual për viktimat.
2. Puna me të strehuarit në Qendër bëhet në tri ndërrime.
3. Stafit të Qendrës është i obliguar të evidentoj vijueshmërinë në punë në formë fizike të shkruar, duke u regjistruar në librin për evidentim të hyrje-daljeve, ose përmes formës elektronike.
4. Nga i gjithë stafi kërkohet të respektohet orari i punës dhe koha e pauzës sipas legjislacionit në fuqi.
5. Qendra për Strehim, ofron kujdestari 24 orë, duke qëndruar në gatishmëri nga ora 16:00 - 08:00.
6. Orari i punës rregullohet bazuar në legjislacionit në fuqi.

Neni 27

Siguria në Qendër

1. Qendra ofron siguri në hapësirën e brendshme dhe të jashtme.
2. Sigurimin e Qendrës e bëjnë zyrtarët e Policisë së Kosovës.
3. Sigurimi fizik i hapësirave të Qendrës dhe monitorimi bëhet njëzetekatër (24) orë në ditë, shtatë (7) ditë në javë nga Policia e Kosovës. Monitorimi i Qendrës bëhet përmes kamerave profesionale.
4. Të gjitha kopjet e çelësave të hapësirës së ndërtesës, janë të vendosura në zyrën e Udhëheqësit/es së Qendrës.
5. Në rast rreziku të ndërtesës ose hapësirave përreth, intervenon Policia e Kosovës e cila bën sigurimin e objektit.
6. Të drejtën e hyrjes brenda objektit të Qendrës, përveç stafit dhe personave të autorizuar e ka edhe Policia e Kosovës, e cila bën sigurimin e objektit, vetëm në raste kur paraqitet ndonjë rrezik.
7. Në rast të ndonjë sulmi nga jashtë, ekziston dhoma e sigurt e cila është e vendosur brenda objektit të Qendrës në të cilën stafi dhe viktimat strehohen përkohësisht deri në evitimin e rrezikut.
8. Dhoma është e pajisur me ujë, ushqime dhe gjëra të tjera elementare për raste të tilla.
9. Në rast rreziku nga zjarri apo ndonjë fatkeqësi tjetër natyrore, Qendra posedon shkallët emergjente për evakuimin e stafit dhe viktimave nga objekti.
10. DRPRIH në MPB, në bashkëpunim me akterët relevant, do të hartojë udhëzuesin e brendshëmmbi rivlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut për Qendrën për Strehim.

KAPITULLI V

ÇËSHTJE TË TJERA LIDHUR ME FUNKSIONIMIN E QENDRËS

Neni 28

Vdekja e viktimës së trafikuar, supozuar

1. Nëse viktimja vdes gjatë qëndrimit të tij/saj në Qendër, Udhëheqësi i Qendrës njofton Policinë, shërbimet e Emergjencës Mjekësore dhe udhëheqësin e DRPRIH-së.
2. Familjen e tij e njofton menaxheri i rastit.
3. Shpenzimet e transportit për në morg dhe arkivol i mbulon MPB-ja.

4. Konstatimi dhe shkaqet e vdekjes bëhen nga organet kompetente në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

5. Kur të afërmit e të ndjerit/ës dëshirojnë ta marrin trupin e tij/saj, ata marrin përsipër shpenzimet e transportit të kufomës për në vendin e origjinës apo prejardhjes së të ndjerit/ës. Nëse shpenzimet nuk mbulohen nga të afërmit e të ndjerit/ës apo nga shteti i origjinës së të ndjerit/ës, MPB mundohet që të gjejë mënyrë për mbulimin e këtyre shpenzimeve dhe ta kthejë kufomën e të ndjerit në vendin e origjinës apo prejardhjes së tij.

6. Nëse të afërmit e të ndjerit apo shteti (vendi) i origjinës apo prejardhjes së të ndjerit nuk dëshirojnë ta marrin kufomën, i ndjeri/a do të varroset në varrezat e komunës në territorin ku gjendet Qendra për Strehim.

7. Shpenzimet e varrimit në Kosovë i mbulon MPB-ja.

8. Zyrtari i Qendrës përpilon një procesverbal lidhur me gjësendet personale të ndjerit/ës.

9. MPB fillon procedurat për kthimin e trupit të pajetë të ndjerit/ës.

Neni 29 **E drejta e ankesës**

1. Viktima ka të drejtë për ankesë tek udhëheqësi i Qendrës lidhur me kushtet në Qendër, sjelljet e zyrtarëve dhe të tjerëve të vendosur në Qendrën e Akomodimit. Ankesa shqyrtohet nga udhëheqësi i Qendrës dhe lidhur me këtë e njofton udhëheqësin e DRPRIH.

2. Në Qendër vendoset kutia e ankesave e cila administrohet nga Qendra.

3. Përjashtimisht paragrafit 2 i këtij neni, një kuti e veçantë vendoset për ankesat të cilat i drejtohen Zyrës së Avokatit të Popullit.

4. Sipas paragrafit 3, Qendra duhet ta përcjellë ankesën pa e hapur, te Zyra e Avokatit të Popullit.

Neni 30 **Shtojcat**

1. Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje, janë shtojcat:

1.1. Shtojca 1: Fletëpranimi;

1.2. Shtojca 2: Gjërat personale të përfituesit;

1.3. Shtojca 3: Deklarata për qëndrim vullnetar;

1.4. Shtojca 4: Fletëpëlqimi për dhënie apo këmbim të informatës;

- 1.5. Shtojca 5: Autorizim për vizita dhe shërbime;
- 1.6. Shtojca 6: Plani i kujdesit të përfituesit;
- 1.7. Shtojca 7: Regjistri i vizitave dhe shërbimeve;
- 1.8. Shtojca 8: Deklaratë për largimin vullnetarë;
- 1.9. Shtojca 9: Forma e transferit/ lëshimit;
- 1.10. Shtojca 10: Deklaratë e Konfidencialitetit;
- 1.11. Shtojca 11: Takimet me Grupin e Ndhmës së Drejtëdrejtë.

KAPITULLI VI DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 31 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja (MPMS) Nr. 01/2016 për Funksionimin dhe Punën në Strehimoren për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore në Nivel të Mesëm dhe të Lartë të Rrezikshmërisë.

Neni 32 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

30 Nëntor /2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo untrasnjih poslova / Ministry of Internal Affairs
Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve / Departament
za Reintegraciju Repatriranijh Lica i Integraciju Stranaca / Department for Reintegration of
Repatriated Persons and Integration of Foreigners
Qendra për Strehimin, Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore
Centar za stanovanje, zaštitu i rehabilitaciju žrtava trgovine ljudima
Center for Housing, Protection and Rehabilitation of Victims of Trafficking in Human Beings

FLETË PRANIMI

Nr. i dosjes _____

**INFORMATAT E PËRGJITHSHME TË
PËRFITUESES/IT**

Emri, emri i prindit & mbiemri: _____

Gjinia: _____

Femër : Mashkull :

Data e lindjes: _____

Vendi i lindjes: _____

Numri i ID/pasaportës: _____

Adresa e banimit: _____

Numri kontaktues për përfituesen/in: _____

Kombësia/Shtetësia: _____

Gjuha e komunikimit përfitueses/it: _____

Religjioni: _____

Statusi martesor: _____

Fëmijë: PO / JO, Nëse PO, sa ____, Të strehuar, sa, ____,

Gjinia e fëmijëve të strehuar: Femra: Meshkuj:

Data e pranimin në Qendër: _____, Dita _____, Ora,

Kategorizimi i llojit të dhunës: _____

Niveli i rrezikshmërisë: _____

Gjendja shëndetësore: _____

**DOKUMENTET E SJELLA NGA REFERUESIT LIDHUR ME
RASTIN:**

1) _____

2) _____

INFORMATAT E REFERUESVE TË RASTIT

Instit. referues:	Emri dhe mbiemri:	# ID i shërbyesit:	Kontaktet	Nënshkrimi:

**VLERËSIMI I GJENDJES DHE I NEVOJAVE EMERGJENTE
TË PËRFITUESES/IT:**

Vendi: _____

Zyrtari i Qendrës: _____

Data: _____



Republika e Kosovës
 Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutrašnjih poslova / Ministry of Internal Affairs
 Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve / Departament
 za Reintegraciju Repatriranijh Lica i Integraciju Stranaca / Department for Reintegration of
 Repatriated Persons and Integration of Foreigners
 Qendra për Strehimin, Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore
 Centar za smeštaj, zaštitu i rehabilitaciju žrtava trgovine ljudima
 Center for Housing, Protection and Rehabilitation of Victims of Trafficking in Human Beings

GJËRAT PERSONALE TË PËRFITUESSES/IT

Nr. i dosjes _____

Përfituesi/ja: _____

Data & ora e dorëzimit të gjërave nga përfituesi/ja: _____

Prezent në pranim:

Nënshkrimi i përfitueses/it:

Zyrtari/ja në Qendër:

Zyrtari/ja referues:

Emërtimi i gjërave:	Lloji:	Sasia:	Numri serik (nëse ka):	Komente shtesë:	✓

Prezent në dorëzim

Data & ora e pranimit të gjërave nga përfituesi/ja

(Me rastin e largimit nga Qendra) _____

Nënshkrimi i përfitueses/it:

Zyrtari/ja në Qendër:

Person i tretë:



Shtojca 3

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutrašnjih poslova / Ministry of Internal Affairs

Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve / Departament za Reintegraciju Repatriranijih Lica i Integraciju Stranaca / Department for Reintegration of Repatriated Persons and Integration of Foreigners

Qendra për Strehimin, Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore
Centar za smeštaj, zaštitu i rehabilitaciju žrtava trgovine ljudima
Center for Housing, Protection and Rehabilitation of Victims of Trafficking in Human Beings

DEKLARATË PËR QËNDRIM VULLNETAR

Nr. i dosjes: _____

Pas leximit të rregullave të Qendrës për Strehimin, Mbrojtjen, Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore, unë _____, e lindur më datë: __/__/____ me vullnetin tim të lirë dhe me vetëdije të plotë, pranoj të strehohem dhe të marrë shërbimet e ofruara institucionale të strehimit, duke respektuar deri në fund të qëndrimit tim Rregulloren e kësaj Qendre. Para nënshkrimit të kësaj deklarate, konfirmoj që nga zyrtari/ja e Qendrës në prezencën e zyrtarit/es të institucionit referues (i/e nënshkruar poshtë), më është lexuar me zë kjo deklaratë, dhe unë e pranoj si të tillë.

Data: _____

Nënshkrimi i përfitueses/it: _____

Ora: _____

Zyrtari/ja nga Institucioni referues: _____ (QPS, PK, MV, etj.)

Vendi: _____

Zyrtari/ja në qendër: _____ (Qendra)



Shtojca 4

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutarasnjih poslova / Ministry of Internal Affairs
Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve / Departament
za Reintegraciju Repatriranijh Lica i Integraciju Stranaca / Department for Reintegration of
Repatriated Persons and Integration of Foreigners
Qendra për Strehimin, Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore
Centar za smeštaj, zaštitu i rehabilitaciju žrtava trgovine ljudima
Center for Housing, Protection and Rehabilitation of Victims of Trafficking in Human Beings

FLETËPËLQIMI PËR DHËNIE APO KËMBIM TË INFORMATËS

Nr. i dosjes _____

Unë _____, i/e lindur më: _____, në _____, e strehuar
në _____, më _____, jap pëlqimin që zyrtari/ja i/e Qendrës të ketë të
drejtën e dhënies apo këmbimit të informatave që kanë të bëjnë me mirëqenien time dhe janë të
lidhur me rastin tim, sipas nevojës dhe kërkesës së akterëve të tjerë referues të përfshirë në rast.

Nënshkrimi i përfitueses/it: _____

Data: _____

Zyrtari/ja në Qendër: _____



Shtojca 5

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutrašnjih poslova / Ministry of Internal Affairs
Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve / Departament
za Reintegraciju Repatriranijh Lica i Integraciju Stranaca / Department for Reintegration of
Repatriated Persons and Integration of Foreigners
Qendra për Strehimin, Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore
Centar za smeštaj, zaštitu i rehabilitaciju žrtava trgovine ljudima
Center for Housing, Protection and Rehabilitation of Victims of Trafficking in Human Beings

AUTORIZIM PËR VIZITA DHE SHËRBIME SHËNDETËSORE

Unë _____, menaxher/e i/e rastit, nga QPS në _____,
me nr.ID, _____, autorizoj personelin e Qendrës, _____,
që në rast nevojë ta bëjë edhe realizimin e vizatave dhe shërbimeve shëndetësore për përfituesen/in në
fjalë. Ky autorizim përfshinë edhe të gjitha nevojat për intervenime emergjente shëndetësore të
përfitueses/it.

Data: _____

Menaxheri/ja i/e rastit nga QPS: _____

Vendi: _____

Zyrtari/ja në Qendër: _____

Personi i tretë: _____



Shtojca 6

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutarasnjih poslova / Ministry of Internal Affairs
Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve / Departament
za Reintegraciju Repatriranijh Lica i Integraciju Stranaca / Department for Reintegration of
Repatriated Persons and Integration of Foreigners
Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore
Centar za smeštaj, zaštitu i rehabilitaciju žrtava trgovine ljudima
Center for Housing, Protection and Rehabilitation of Victims of Trafficking in Human Beings

1. DETAJET E PËRFITUESES/IT

PLANI I KUJDESIT TË PËRFITUESES/IT

Emri dhe mbiemri: _____

Data e lindjes: _____

Vendlindja: _____

Arsimimi (specifiko): _____

Shtetësia: _____, kombësia: _____

Gjuha: _____, religjioni: _____

Data dhe ora e pranimit në Qendër: _____

2. ZYRTARI QENDER, _____ Kontaktet _____

3. HISTORIK I SHKURTË I RASTIT:

4. SEKSIONET E KUJDESIT

1) SHËNDETI

1.1. Gjendja e përgjithshme shëndetësore

1.2. Shëndeti mendor

1.3. Shëndeti dental

1.4. Imunizimi/vaksinimi

Realizimi i planit në bazë të datave:

Rishqyrtimi ¹:

<p>2) MBROJTJA LIGJORE</p> <p>2.1. Identifikimi i nevojave për këshilla dhe ndihmë juridike (në bashkëpunim me Mbrojtësit e Viktimave)</p> <p>2.2. Identifikimi i nevojës për ekspertizë mjeko-ligjore (në bashkëpunim me Mbrojtësit e Viktimave, Punonjësit Social dhe Policinë e Kosovës)</p>	<p><u>Realizimi i planit në bazë të datave:</u></p>
<p><u>Rishqyrtimi ²:</u></p>	

<p>3) TRAJTIMI PSIKOSOCIAL</p> <p>3.1. Këshillimi psikologjik (seancat individuale dhe grupe)</p> <p>3.2. Risocializimi/ përgatitja e përfitueses për riintegrim në komunitet</p>	<p><u>Realizimi i planit në bazë të datave:</u></p>
<p><u>Rishqyrtimi ³:</u></p>	

<p>4) <u>KONTAKTET ME PARTENRËT REFERUES</u></p> <p>4.1. Kontaktet me Qendrën për Punë Sociale:</p> <p>4.2. Kontaktet me Mbrojtësin e Viktimave:</p> <p>4.3. Kontaktet me Policinë e Kosovës:</p> <p>4.4. Të tjerë:</p>	<p><u>Realizimi i planit në bazë të datave:</u></p>
<p><u>Rishqyrtimi ⁴:</u></p>	

¹ Rishqyrtimi i planit obligativisht nga menxherët e rastit duhet të bëhet të paktën çdo 30 ditë

² Rishqyrtimi i planit obligativisht nga menxherët e rastit duhet të bëhet të paktën çdo 30 ditë

³ Rishqyrtimi i planit obligativisht nga menxherët e rastit duhet të bëhet të paktën çdo 30 ditë

⁴ Rishqyrtimi i planit obligativisht nga menxherët e rastit duhet të bëhet të paktën çdo 30 ditë

<p>5) <u>KONTAKTET DHE TAKIMET ME FAMILJARË</u></p> <p>5.1. Përcaktimi i nevojave për kontakte me telefon dhe takimet me familjarë</p> <p>5.2. Hartimi i planit për kontakte dhe takime familjare të përfitueseve bashkërisht me punonjës të social, mbrojtës të viktimave dhe me policin hetues;</p>	<p><u>Realizimi i planit në bazë të datave:</u></p>
<p><u>Rishqyrtimi ⁵:</u></p>	

<p>6) <u>ARSIMIMI</u></p> <p>6.1. Niveli arsimor përfitueses/it</p> <p>6.2. Nevojat për arsimim të mëtutjeshëm</p>	<p><u>Realizimi i planit në bazë të datave</u></p>
<p><u>Rishqyrtimi ⁶:</u></p>	

⁵ Rishqyrtimi i planit obligativisht nga menxherët e rastit duhet të bëhet të paktën çdo 30 ditë

⁶ Rishqyrtimi i planit obligativisht nga menxherët e rastit duhet të bëhet të paktën çdo 30 ditë

<p>7) <u>AFTËSIMI PROFESIONAL PËR PAVARËSI EKONOMIKE</u></p> <p>7.1. Kapacitetet ekzistuese profesionale të përfitueses</p> <p>7.2. Përcaktimi i nevojave të mëtutjeshme për aftësime (kurset/trajnimet profesionale)</p>	<p><u>Realizimi i planit në bazë të datave:</u></p>
<p><u>Rishqyrtimi ⁷:</u></p>	

<p>8) <u>SHKATHTËSITË PËR JETË</u></p> <p>8.1. Kapacitetet/shkathtësitë ekzistuese të përfitueses</p> <p>8.2. Përcaktimi aktiviteteve të mëtutjeshme për përfituesen</p> <p>8.3. Edukimi për të Drejtat e njeriut, Edukimi shëndetësor/riprodhues, si edhe Edukimi psikosocial</p>	<p><u>Realizimi i planit në bazë të datave:</u></p>
<p><u>Rishqyrtimi ⁸:</u></p>	

⁷ Rishqyrtimi i planit obligativisht nga menxherët e rastit duhet të bëhet të paktën çdo 30 ditë

⁸ Rishqyrtimi i planit obligativisht nga menxherët e rastit duhet të bëhet të paktën çdo 30 ditë

<p>9) <u>AKTIVITETET REKREATIVE</u></p> <p>9.1. Aktivitetet rekreative ditore individuale dhe grupore</p> <p>9.2. Respektimi i planit dhe orarit të aktiviteve rekreative</p>	<p><u>Realizimi i planit në bazë të datave:</u></p>
<p><u>Rishqyrtimi ⁹:</u></p>	

<p>10) <u>PLANI AFATGJATË PËR PËRFITUESIN/EN</u></p> <p>10.1. Rikthim në familje</p> <p>10.2. Riatdhesim</p> <p>10.3. Jetesë e pavarur</p>	<p><u>Realizimi i planit në bazë të datave:</u></p>
<p><u>Rishqyrtimi ¹⁰:</u></p>	

Zyrtari/ja në Qendër:

Përfituesi/ja:

Personi i tretë:

Data: _____,

Data: _____,

Data: _____.

⁹ Rishqyrtimi i planit obligativisht nga menxherët e rastit duhet të bëhet të paktën çdo 30 ditë

¹⁰ Rishqyrtimi i planit obligativisht nga menxherët e rastit duhet të bëhet të paktën çdo 30 ditë



Shtojca 8

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutrašnjih poslova / Ministry of Internal Affairs
Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve / Departament
za Reintegraciju Repatriranijh Lica i Integraciju Stranaca / Department for Reintegration of
Repatriated Persons and Integration of Foreigners
Qendra për Strehimin, Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore
Centar za smeštaj, zaštitu i rehabilitaciju žrtava trgovine ljudima
Center for Housing, Protection and Rehabilitation of Victims of Trafficking in Human Beings

DEKLARATË PËR LARGIM VULLNETAR

Nr. i dosjes _____

Unë _____, i/e lindur më _____, i/e strehuar në Qendrën për SRMVTQNJ,
më _____, përkundër këshillave dhe sugjerimeve të stafit të Qendrës dhe partnerëve referues **QPS**,
MV, PK, të përfshirë në rastin tim, me vetedije të plotë dhe me vullnetin tim të lirë, sot më _____,
largohehem nga Qendra për SRMVTQNJ dhe transferohem në MVPT.

Data: _____

Nëshkrimi i përfitueses/it: _____

Vendi: _____

Zyrtari/ja në Qendër: _____

Personi i tretë: _____



Shtojca 9

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutrašnjih poslova / Ministry of Internal Affairs
Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve / Departament
za Reintegraciju Repatriranijh Lica i Integraciju Stranaca / Department for Reintegration of
Repatriated Persons and Integration of Foreigners
Qendra për Strehimin, Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore
Centar za smeštaj, zaštitu i rehabilitaciju žrtava trgovine ljudima
Center for Housing, Protection and Rehabilitation of Victims of Trafficking in Human Beings

1. Detalet e përfitueses/it

FORMA E TRANSFERIT/LËSHIMIT

Nr. i dosjes: _____

Emri dhe mbiemri: _____
Data e lindjes: _____
Vendlindja: _____
Arsimimi (specifiko): _____
Shtetësia: _____
Kombësia: _____
Gjuha: _____
Religjioni: _____
Data e pranimit në strehimore: _____
Data e lëshimit të strehimores: _____
Institucioni referues i përfitueses: _____
Zyrtari referues dhe kontaktet: _____

2. Historiku i shkurtë i rastit:

RAPORTI MBI KUJDESIN

Lloji i shërbimeve të ofruara	Realizimi i shërbimeve	Rekomandimet
<i>Shëndet</i>		
<i>Mbrojtja ligjore</i>		
<i>Trajtimi psikosocial</i>		
<i>Kontaktet me partnerët referues</i>		
<i>Kontaktet dhe takimet me familjarë</i>		
<i>Arsimimi</i>		
<i>Aftësimi profesional për pavarësi ekonomike</i>		
<i>Shkathësitë për jetë</i>		
<i>Aktivitetet rekreative</i>		
<i>Plani afatgjatë për përfituesen/in</i>		
<i>Vendi ku po transferohet (relacioni familjar, adresa, kontakti)</i>		

Zyrtari/ja në Qendër: / Data:

Personi i tretë: / Data

Përfituesi/ja: / Data:

_____ /

_____ /

_____ /



Shtojca 10

Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria / Vlada / Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutarasnjih poslova / Ministry of Internal Affairs
Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve / Departament
za Reintegraciju Repatriranijh Lica i Integraciju Stranaca / Department for Reintegration of
Repatriated Persons and Integration of Foreigners
Qendra për Strehimin, Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore
Centar za smeštaj, zaštitu i rehabilitaciju žrtava trgovine ljudima
Center for Housing, Protection and Rehabilitation of Victims of Trafficking in Human Beings

DEKLARATË E KONFIDENCIALITETIT/E RUAJTJES SË SEKRETIT

(Emri dhe mbiemri) _____, me dokument identifikimi _____, lloji i shërbimit: _____,
me numër licence _____ . Me përgjegjësinë time të plotë, deklaroj që në përputhje me ligjin
nr. _____ “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, nuk do të përhap në asnjë lloj forme dhe me askënd
për informacionin për të cilin vihem në dijeni gjatë kryerjes së këtij shërbimi.

Shërbimi i ofruar: _____

Nënshkrimi: _____

Ofruesi shërbimit: Emri dhe mbiemri _____

Data: _____

